



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**DËGJESË PUBLIKE PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR TË BASHKISË KAMËZ**

I mbajtur 22.07.2024 në orën 16:30 , në dëgjesën me banorët e Bashkië Kamëz në lidhje me rishikimin e planit të përgjithshëm vendor dhe ndërtimit të godinës së re të Bashkisë Kamëz.

Takimi u zhvillua në pallatin e kulturës “Artan Cuku”.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamëz, Z. Rakip Suli;
- Administratorët e lagjeve administrative;
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Qytetarët e zonës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administatores së Njesisë Administrative nr. 2, Blerta Matraku, ku i njohu qytetarët për qëllimin e takimit.

Më pas fjalën e mori Kryetari i Bashkisë Kamëz, Z. Rakip Suli, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit në takim bëri një përmbledhje të investimeve të kryera deri më tani në infrastrukturë, arsim dhe çështje sociale. Gjatë fjalimit të tij, Kryetari i Bashkisë Z.Rakip Suli i njohu qytetarët me draftin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për disa ndryshime të treguesve zhvillimor që paraqiten në pasaportat e njësive strukturore, ku këto njësi strukturore prekin qytetin e Kamzës dhe lagjen nr. 2.

Njësitë strukturore ku përfshihen ndryshimet e parametrave të zhvillimit, janë:

- KZ_UB_AR3_14/315 në të cilën u fol edhe për ndërtimin e godinës së re të Bashkisë Kamëz
- KZ_UB_AS2_14/196;
- KZ_UB_A2_14/427;
- KZ_UB_IS2_14/316.

Kryetari i Bashkisë Kamëz Z. Rakip Suli, më tej informoi pjesëmarrësit në lidhje me ndërtimin e godinës së re të Bashkisë Kamëz:

- Godina e re do të ndërtohet në fushën e stadiumit të Kamzës
- Godina e re e Bashkisë do të jetë 3-re kate dhe do të ketë mbi 2000 metra katrorë sipërfaqe;
- Me parkim nëntokësor;
- Me hapsira rekreative.

Gjatë fjalës së tij, Kryetari i Bashkisë Z.Rakip Suli u shpreh: “Bashkia është simbol për qytetin, fal këtij investimi strategjik, lehtësohen shumë qytetarët me krijimin e parkimeve nëntokësore dhe hapësirave të gjelbërta dedikuar të gjitha grup moshave. Bashkia është institucion që ju përket qytetarëve dhe do të jetë nën shërbim të qytetarëve”, kjo sjell si pasojë rishikimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Kamëz, në mënyrë që të realizohet investimi i mësipërm.

Secilit pjesëmarrës në takim ju dha mundësia dhe koha për të bërë pyetje dhe për të dhënë sugjerime mbi draft dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe projektit të godinës së re të Bashkisë Kamëz.

Në fund të diskutimit Kryetari i Bashkisë Z.Rakip Suli, falenderoi të pranishmit duke thënë se çdo pyetje apo sugjerim i qytetarëve do të merret parasysh.

